

Albanska

MIRË SE VINI TE

Vizita 4-vjeçare!



Përshëndetje adult!

Në vizitën 4-vjeçare do të takoheni me një infermiere. Siç është bërë më parë, do të ndjekim shëndetin, rritjen dhe zhvillimin e fëmijës suaj. Ndonjëherë do të jetë e nevojshme që fëmija të shohë figura që ta kemi më të lehtë të vlerësojmë zhvillimin e të folurit të fëmijës suaj. Vizita pritet të zgjatë të paktën 45 minuta.

Do t'ju dërgojmë një pyetësor që t'i përgjigjeni. Merreni formularin me vete kur të vini. Jeni ju si prind që dini më shumë për fëmijën tuaj, ndaj gjatë vizitës sigurisht mund të bëni të gjitha pyetjet që doni. Për shembull, pyetjet lidhur me prindërimin, shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, gjumi, ushqimin, vajtjen në banjë dhe mirëqenien tuaj si prind.

Fëmijëve u pëlqen të dinë se çfarë do të ndodhë, njëlloj si ne të rriturve. Ju lutemi ndihuni të lirë të shihni këtë dosje me fëmijën tuaj para vizitës dhe të flisni së bashku se çfarë do të ndodhë gjatë vizitës dhe çfarë do të bëjë fëmija juaj.

Gjithashtu do t'ju jepet mundësia të shkoni në një qendër shëndetësore kur fëmija të bëhet 5 vjeç.



Skani kodin QR ose vizitoni faqen e internetit 1177.se/jamtland-harjedalen/barn. Aty gjenden fakte dhe këshilla lidhur shëndetin, zhvillimin, të drejtat dhe kujdesin për fëmijët. Gjithashtu mund të lexohen informacione për prindërimin.



Përshëndetje fëmijë!

Nu Tani është momenti për vizitën 4-vjeçare në qendrën shëndetësore të fëmijëve. Në këtë vizitë, ju dhe prindi juaj do të takoheni me një infermiere.

Ja se çfarë do të bëni gjatë vizitës:

Do të mateni dhe do të peshoheni për të parë se sa jeni rritur që nga vizita e fundit.



Testi i syve me tabelë



Vizato




Kalimi i rruazave



Numëro 3 objekte dhe trego emrat e ngjyrave



Ec me ekuilibër





Nëse keni ndonjë pyetje para vizitës, ju lutemi të kontaktoni qendrën shëndetësore të fëmijëve.